

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
Fakulteti i Filologjisë
Departamenti: Gjuhë dhe Letërsi Gjermane

Përshkrimi i moduleve / lëndëve të studimit:

Viti I – Semestri I

Lëndët obligative:

S1 Mësimdhënësi: Prof.ass.dr. Ilir Krusha		
Nr.	Lënda:	1.1 Gjuhë Gjermane I, Praktikë gjuhe (A2/1)
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri I
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatja dhe proporcioni:	15 javë, 2+2
5	ECTS kreditë:	4
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	<p>Lënda ka për qëllim t'i ofrojë studentit njohuri elementare gramatikore. Theks i veçantë do t'i kushtohet praktikimit të gjuhës gjermane si në të folur, po ashtu edhe në të shkruar. Kjo lëndë synon zhvillimin e shkathtësive komunikative dhe sociale të nevojshme për komunikim në këtë gjuhë, si: të shkruarit, të lexuarit, të folurit dhe të dëgjuarit. Ushtrohen strategji të ndryshme të të lexuarit dhe të dëgjuarit (global, selektiv e të detajuar). Po ashtu ushtrohen shkathtësitë produktive (tiparet e llojeve të ndryshme të teksteve, të folurit) dhe ato receptive. Të katër shkathtësitë do të ushtrohen përmes trajtimit të temave të ndryshme. Në temat që do të përpunohen gjatë këtij semestri bëhet pasurimi i leksikut të studentëve me fjalë të reja të nivelit gjuhësor të lartë cekur. Për zhvillimin e mësimin do të përdoren krahas teksteve nga libri bazë edhe tekste autentike që ndërliken me përditshmërinë, gramatikat e gjuhës gjermane për të huaj, CD-të për ushtrimin e shkathtësisë së të dëgjuarit dhe format digjitale, të cilat i ofron botuesi i literaturës, siç janë: platformë e internetit për ushtrime online dhe aplikacione për celularët mobil etj. Gjatë ushtrimeve studentët do të prezantojnë edhe punime seminarike me tema të ndryshme, të cilat janë në përputhje me programin e lëndës.</p> <p>Objektivat e lëndës: t'i aftësojë studentët të kombinojnë gjuhën me shkathtësitë reale</p>

		<p>jetësore; të ngrisë vetëbesimin e studentëve dhe aftësinë e tyre për të komunikuar me folësit e gjermanishtes; t’i mundësohet studentit të bëhet përdorues eficient dhe fleksibil i gjuhës gjermane si për qëllime personale, po ashtu edhe për ato profesionale; të inkurajohet mësim-nxënia e pavarur.</p>
	Rezultatet e pritura:	<p>të dëshmojë që zotëron njohuri elementare të gramatikës gjermane; të kuptojë informacionet më të rëndësishme në biseda të jetës së përditshme, por edhe njoftime të shkurtra në radio apo mesazhe në telefon; të nxjerrë informacionet e rëndësishme nga artikuj të shkurtër gazetash, njoftime që kanë të bëjnë me jetën e përditshme dhe nga tabela udhëzuese; të shkruajë mesazhe, të cilat lidhen drejtpërdrejt me mjedisin që i rrethon; të formulojë pyetje rreth temave të jetës së përditshme dhe të reagojë ndaj tyre; në biseda të përditshme të bjerë dakord ose të negociojë për diçka.</p>
7	Metodat e mësimdhënies:	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet përdorimit të metodave të kombinuara dhe qasje kognitive, komunikative dhe ndërkulturore për ta arritur përmirësimin e shkathtësive receptive dhe produktive gjuhësore. Përmes metodës bashkëbiseduese punohet në mënyrë individuale, në çifte dhe në grupe. Studentët duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësim dhe të punojnë vazhdimisht gjatë semestrit (detyra të shtëpisë dhe projekte të ndryshme).</p>
8	Vlerësimi dhe notimi	<p>Vlerësimi me pikë: 01-49= 5, 50-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10 Provimi: Të dëgjuarit – 20% Të lexuarit – 20% Të shkruarit –20% Të folurit – 20% Pjesëmarrja & aktiviteti: 20 %</p>
9	Literatura:	<p>Literatura bazë: Specht/Habersack/Pude: Menschen A2/1. Kursbuch mit DVD-ROM. Niveau: A2/1. Hueber Verlag 2013. Sarita Batra/Karin Ransberger: Menschen A2: Deutsch als Fremdsprache/Intensivtrainer mit Audio-CD . 2016. Literatura shtesë Christiane Lemcke, Lutz Rohrmann/Grammatik Intensivtrainer NEU A2/ Deutsch als Fremdsprache (DaF) Niveau: A2/Klett Verlag 2017.</p>

		<p>Christiane Lemcke, Lutz Rohrmann/Wortschatz Intensivtrainer NEU A2/ Deutsch als Fremdsprache (DaF) Niveau: A2/Klett Verlag 2017.</p> <p>Christiane Lemcke, Lutz Rohrmann/Schreiben Intensivtrainer NEU A2/ Deutsch als Fremdsprache (DaF) Niveau: A2/Klett Verlag 2017.</p> <p>Duden: Die Grammatik (Der Duden Band 4). 7., völlig neu erarbeitete und erweiterte Auflage. Mannheim. Dudenverlag 2005.</p> <p>Karin Hall / Barbara Scheiner: Übungsbuchgrammatik. Deutsch als Fremdsprache. Max Huber Verlag 2001.</p> <p>Langenscheidt Handwörterbuch Deutsch-Albanisch Albanisch-Deutsch, Langenscheidt 1999.</p> <p>Langenscheidt Wörterbuch Deutsch als Fremdsprache Bild für Bild - Bildwörterbuch: 7.500 Begriffe, Redewendungen und Sätze in tausenden Bildern, Deutsch (Langenscheidt Wörterbuch Bild für Bild) Taschenbuch. 2016</p> <p>Wiebke Strank: Da fehlen mir die Worte. Systematische Wortschatzerwerb für fortgeschrittene Lerner in Deutsch als Fremdsprache. Schubert Verlag. Leipzig 2010.</p>
--	--	--

S1 Mësimdhënësi: Prof.ass.dr. Kimete Canaj		
Nr.	Lënda:	1.2 Gramatikë e gjuhës gjermane I (bazat)
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri I
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatjadhe proporcioni:	15 javë, 2+2
5	ECTS kreditë:	6
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	<p>Lënda synon të merret fillimisht me definicionet bazë të gramatikës, fokusimi në karakteristikat gramatikore të gjuhës gjermane dhe në bazat e karakterizimit të tipologjisë së gjermanishtes, t'i sqarojë vështirësitë gramatikore të gjuhës gjermane.</p> <p>Kjo lëndë do t'i adresojë vështirësitë e veçanta të gramatikës së gjuhës gjermane:</p>

	Rezultatet e pritura:	njohja me parimet gramatikore të gjuhës gjermane; të kuptuarit e koncepteve themelore gramatikore është një nga synimet kryesore të lëndës; të kuptuarit e proceseve gramatikore dhe parimeve morfologjike e sinataksore të gjermanishtes; mësimi i pjesëve të ligjëratës dhe aftësimi i studentëve për aplikimin e tyre në mënyrë të drejtë.
7	Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratë, ushtrime, 2 pjesë provimesh, prezantime, provimi përfundimtar
8	Vlerësimi dhe notimi	Vlerësimi me pikë: 01-49= 5, 50-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10 / Pjesëmarrja & aktiviteti: 20 %; Pjesa e parë e provimit: 30 % ; Pjesa e dytë e provimit: 30%; Provimi me gojë: 20 %
9	Literatura:	Eisenberg, Peter (2006): Grundriss der deutschen Grammatik. Band 1: Das Wort. 3. Auflage. Stuttgart, Weimar: Metzler. Eisenberg, Peter (2006): Grundriss der deutschen Grammatik. Band 2: Der Satz. 3. Auflage. Stuttgart, Weimar: Metzler. Engel, Ulrich: Deutsche Grammatik. Neubearb. München: Iudicium 2004. Helbig, Gerhard / Joachim Buscha (2013): Deutsche Grammatik, Ein Handbuch für Ausländerunterricht. München: Klett-Langenscheidt. Hoffman, Ludger (2014): Deutsche Grammatik. Grundlagen für Lehrerausbildung, Schule, Deutsch als Zweitsprache und Deutsch als Fremdsprache 2 Aufl.. Berlin: Erich Schmidt Verlag. Duden, Band 4. Die Grammatik. Hrsg. von der Dudenredaktion. Neudruck der 9. Aufl. Mannheim [u.a.]: Dudenverlag 2016. Dreyer, Hilke / Schmitt, Richard: Lehr- und Übungsbuch der deutschen Grammatik. München: Ismaning 2013. DUDEN. Die Grammatik. Hrsg. von den Dudenredaktion. Band 4. Mannheim, Wien u.a.: Dudenverlag 82009. Hall, Karin / Schneider, Barbara: Übungsgrammatik für Fortgeschrittene DaF. München: Ismaning 2013. Helbig, Gerhard /Buscha, Joachim Deutsche Grammatik. Ein Handbuch für den Ausländerunterricht. Berlin, München u. a.: Langenscheidt 2013. Helbig, Gerhard /Buscha, Joachim: Übungsgrammatik. Leipzig: Langenscheidt 2000.

S1 Mësimdhënësi: Prof.asoc.dr. Izer Maksuti		
Nr.	Lënda:	1.3 Hyrje në linguistikë gjermane
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri I
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatjadhe proporcioni:	15 javë, 2+2
5	ECTS kreditë:	6
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	Kjo lëndë është një shqyrtim i linguistikës në përgjithësi, duke theksuar teorinë dhe metodologjinë e fushave qendrore tradicionale në fushën e fonetikës, fonologjisë, morfologjisë dhe sintaksës - me koncentrim të veçantë në teoritë fonologjike dhe sintaksore dhe teknikat analitike. Përsëritja e lëndës do t'i mbulojë temat në: fonetikë, morfologji, semantikë dhe pragmatikë, sociolinguistikë, psikolinguistikë dhe lingustikë historike.
	Rezultatet e pritura:	Njohja me objektin e studimit të disiplinës teorike: Gjuhësi e përgjithshme, aplikative dhe historike. Të kuptuarit e koncepteve themelore të gjuhësisë është një nga synimet kryesore të lëndës. Njohja e metodave themelore të studimit në gjuhësi, teoritë më të përhapura dhe njohje e përgjithshme për historinë e ideve në këtë fushë.
7	Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, 2 pjesë provimesh, prezantime, provimi përfundimtar
8	Vlerësimi dhe notimi	Vlerësimi me pikë: 01-49= 5, 50-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10 / Pjesëmarrja & aktiviteti: 20 %; Pjesa e parë e provimit: 30 % ; Pjesa e dytë e provimit: 30%; Provimi me gojë: 20 %
9	Literatura:	Buch, Albert/Stenschke, Oliver (2008): Germanistische Linguistik. Eine Einführung. 2. durchges. u. korr. Aufl. Tübingen: Narr. Graefen, Gabriele/Liedke, Martina (2012): Germanistische Sprachwissenschaft. Deutsch als Erst-, Zweit- oder Fremdsprache. 2., überarb. u. erweiterte Auflage. mit CD-ROM. Tübingen: A. Franke Verlag. Ossner, Jakob/ Zinsmeister, Heike (Hrsg.): Sprachwissenschaft für das Lehramt. Ferdinand Schöningh, Paderborn 2014.

S1 Mësimdhënësi: Prof.ass.dr. Naim Kryeziu		
Nr.	Lënda:	1.4 Hyrje në letërsinë gjermane (në shkencën e letërsisë)
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri I
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatjadhe proporcioni:	15 javë, 2+2
5	ECTS kreditë:	6
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	<p>Lënda fillimisht trajton problemet teorike të letërsisë në përgjithësi dhe më vonë fokusohet në problemet e letërsisë gjermane. Në këtë fushë, para së gjithash bëhet përpjekje që studentët të marrin njohuri mbi kualifikimet kyçe të punës si: teknikat e punës, marrja e informacioneve, kritika e tekstit, bazat e analizës së tekstit, por edhe informacione më të zgjeruara mbi letërsinë në përgjithësi dhe letërsinë gjermane në veçanti. Njëkohësisht do të ketë një praktikë tekstuale në mënyrë metodike. Në kuadër të kësaj lënde ushtrohet gjithashtu me literaturën dhe kërkimet duke përdorur monografitë ndihmëse dhe mjetet tjera shkencore. Njëkohësisht do të jetë një ushtrim i të mendurait kritik gjatë leximit të teksteve letrare.</p> <p>Qëllimet e kësaj lënde janë që studenti të arrijë të njohë teknikat e punës, të arrijë të marrja e informacioneve, gjithashtu kritika e tekstit dhe bazat e analizës së tekstit janë objektiva të kësaj lënde. Gjithashtu do të merren informacione më të zgjeruara mbi letërsinë në përgjithësi dhe letërsinë gjermane në veçanti, si : epokat e zhvillimit të historisë së letërsisë gjermane, veçoritë më thelbësore të letërsisë gjermane dhe veprat e autorët më kryesorë të letërsisë gjermane.</p>
	Rezultatet e pritura:	<p>Pas përfundimit të këtij kursi (lënde), studenti do të jetë në gjendje që të dëshmojë që zotëron njohuri në fushën e shkencës së letërsisë gjermane, të cilat njohuri mund t'i përdorë gjatë studimeve të mëtejshme. Të dëshmojë që zotëron njohuri dhe shkathtësi në fushën e kërkimit shkencor, që janë esenciale për përpilimin e punimeve seminarike. Të dëshmojë që zotëron njohuri dhe shkathtësi rreth gjinive letrare dhe të analizojë ato.</p>
7	Metodat e mësimdhënies:	<p>Në procesin e mësimdhënies zbatohet metodologjia bashkëkohore. Format e ndryshme të ligjërimit të modifikuar, punë e pavarur e studentëve sipas formave bashkëkohore të bashkëpunimit (reflektim individual me gojë e me shkrim, punë në dyshe, punë në grupe të vogla, lexim i vëmendshëm dhe detyra me shkrim).</p>

8	Vlerësimi dhe notimi	Vlerësimi me pikë: 01-49= 5, 50-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10 / Pjesëmarrja & aktiviteti: 20 %; Pjesa e parë e provimit: 30 % ; Pjesa e dytë e provimit: 30%; Provimi me gojë: 20 %
9	Literatura:	Allkemper, Alo/Eke, Norbert O.: Literaturwissenschaft: Eine Einführung in die Literaturwissenschaft. Wilhelm Fink Verlag 2010. Klewitter, Anne/Ostheimer, Michael: Literaturtheorie – Ansätze und Anwendungen. Göttingen: Vandenhoeck&Rupprecht 2008. Kafitz, Dieter: Literaturtheorien in der textanalytischen Praxis. Würzburg: Königshausen&Neumann 2007. Schultes-Sasse, Jochen/ Werner, Renate: Einführung in die Literaturwissenschaft. München: Wilhelm Fink Verlag 1977. Vogt, Jochen: Einladung zur Literaturwissenschaft. München: Wilhelm Fink Verlag 1991. Vogt, Jochen: Wie analysiere ich eine Erzählung? München: Wilhelm Fink Verlag 2011.

S1 Mësimdhënësi: Prof.ass.dr. Ilir Krusha		
Nr.	Lënda:	1.5 Civilizimi dhe kultura gjermane I
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri I
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatja dhe proporcioni:	15 javë, 2+1
5	ECTS kreditë:	4
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	Kush flet gjuhën gjermane ose dëshiron ta mësojë atë, duhet t'i njohë edhe tiparet themelore të kulturës, gjuhës dhe letërsisë gjermane. Fitimi i njohurive bazë për historinë e kulturës gjermane, me theks të veçantë në ndërlidhjen që ekziston mes ngjarjeve historike dhe atyre kulturore. Studimi i historisë së kulturës si bazë për t'i kuptuar çështjet aktuale politike dhe kulturore, si dhe identitetin kulturor gjerman. Kombinimi i njohurive nga fusha të ndryshme të kulturës gjermane, si letërsia, arti, arkitektura, muzika. Sensibilizimi i studentëve për ngjarjet kulturore-politike në historinë gjermane. Do të trajtohen ngjarjet dhe personalitetet më të rëndësishme historike e kulturore, proceset sociale dhe ekonomike, të arritura kryesore në filozofi,

		në artin figurativ dhe të arkitekturës, letërsisë, si dhe fenomene tjera kulturore në të kaluarën (institucionet më të rëndësishme, jeta e përditshme, botëkuptimet etj.).
	Rezultatet e pritura:	Aftësimi i studentëve për punë të pavarur për hulumtimin, interpretimin dhe paraqitjen e informacioneve për historinë dhe kulturën gjermane. Në këtë ligjeratë, si dhe referatet e studentëve (si punë në grupe) do të trajtohet periudha prej antikitetit deri tek epoka e reformacionit. Në këtë semestër, studentët marrin njohuri themelore për historinë e kulturës gjermane prej kohës së antikitetit të gjermanikëve deri te periudha e reformacionit gjerman nga Martin Lutheri. Njëkohësisht ata fitojnë aftësi kritike për zhvillimin dhe të identitetin kulturor, bëjnë ndërlidhjen e aspekteve të ndryshme të kulturës dhe janë në gjendje t'i dallojnë dhe t'i interpretojnë ato në mënyrë të pavarur.
7	Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, 2 pjesë provimesh, prezantime, provimi përfundimtar
8	Vlerësimi dhe notimi	Vlerësimi me pikë: 01-49= 5, 50-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10 / Pjesëmarrja & aktiviteti: 20 %; Pjesa e parë e provimit: 30 % ; Pjesa e dytë e provimit: 30%; Provimi me gojë: 20 %
9	Literatura:	Literatura bazë: Beyme, Klaus: Kulturpolitik in Deutschland: Von der Staatsförderung zur Kreativwirtschaft, Springer Fachmedien, Wiesbaden, 2012. Die Geschichte der Deutschen erzählt Wilhelm von Sternburg, Campus Verlag, Frankfurt/New York, 2005. Demant, Alexander: Über die Deutschen. Eine kleine Kulturgeschichte, Propyläen-Berlin, 32009. Gössmann, Wilhelm: Deutsche Kulturgeschichte im Grundriss, Gruppello Verlag- Düsseldorf, 2006. Hamann, Richard: Geschichte der Kunst, Th.Knaur-Verlag, München, 1932, S.377-476;681-896. Jordan, Gerda, Deutsche Kultur in Epochen, Peter Lang, New York, 1993. Kleine deutsche Geschichte, Reclam, Stuttgart, 2006. Naumann, Günter, Deutsche Geschichte. Das Alte Reich 925-1806, Marix Verlag Wiesbaden, 2009. Van Dülmen, Richard: Kultur und Alltag in der Frühen Neuzeit. Das Haus und seine Menschen, C. H. Beck, München, 2005.

	<p>Online resurset:</p> <p>https://www.tatsachen-ueber-deutschland.de/de/system/files/download/tatsachen_2015_deu.pdf https://www.tatsachen-ueber-deutschland.de/partner/epaper/epaper-Jugendbuch_TuD_2015_DEU/</p> <p>Literatura shitesë:</p> <p>Die mittelalterliche Kunst in Deutschland, në: Hamann, R. "Geschichte der Kunst", Knauer, Berlin, 1932, fq. 213-337. Bumke J. Höfische Kultur.Literatur und Gesellschaft im hohen Mittelalter,dtv München, 102008. Moebius S./Quadflieg D. (Hrsg.), Kultur.Theorien der Gegenwart, VS Verlag, Wiesbaden, 2006.</p>
--	--

S1 Mësimdhënësi: Prof. ass. dr. Xhafer Beqiraj		
Nr.	Lënda:	1.6 Gjuhë shqipe I
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri I
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatja dhe proporcioni:	15 javë, 2 + 2
5	ECTS kreditë:	4

	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës:	<p>Lënda (kursi) ka për qëllim që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të kuptojnë drejt objektin e studimit të disiplinës së morfologjisë, e cila është njëra nga disiplinat mjaft të rëndësishme të gjuhës. Njohja në nivel të duhur të Gjuhës shqipe I (Morfologji) do t'u ndihmojë studentëve të Programit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane të mësojnë dhe përvetësojnë më lehtë dhe më mirë gramatikën e gjermanishtes; të aftësohen për njohjen sa më të mirë të klasave të fjalëve (pjesëve të ligjëratës) të ndryshueshme dhe të pandryshueshme; ta zbatojnë drejtshkrimin e trajtave të fjalëve dhe t'i kuptojnë mirë kategoritë gramatikore të tyre; t'i shkruajnë drejt trajtat e fjalëve në fjali; t'i zhvillojnë aftësitë e komunikimit dhe transmetimit të dijes së tyre; të jenë në gjendje të zbatojnë njohuritë e fituara nga fusha e morfologjisë; të aftësohen për punë kërkimore-hulumtues individuale e grupe; t'i zhvillojnë aftësitë për të hulumtuar, krahasuar, analizuar e për të sintetizuar etj.
6	Rezultatet e pritura:	<p>Pikësypnim kryesor i lëndës është që studentët:</p> <ul style="list-style-type: none"> të kuptojnë se njohja e morfologjisë së shqipes është me rëndësi të veçantë jo vetëm për të zotëruar në nivel të duhur gjuhën amtare, por përmes saj studentët do ta kenë më të lehtë mësimin e gramatikës së gjermanishtes; t'i përvetësojnë klasat e fjalëve (pjesët e ligjëratës) të ndryshueshme dhe të pandryshueshme dhe t'i dallojnë mirë ato, si: pjesët e ndryshueshme të ligjëratës; pjesët e pandryshueshme të ligjëratës; fjalët e lakueshme: emrat, mbiemrat, përemrat, numërorët dhe fjalët e zgjedhueshme–foljet; t'i përvetësojnë kategoritë gramatikore të secilës klasë; të kuptojnë mirë fjalëformimin dhe t'i kuptojnë tipat e fjalëformimit; njohja e mirë e morfologjisë do t'u ndihmojë atyre edhe në zotërimin e sintaksës, sepse pa zotërimin e mirë të morfologjisë nuk ka mundësi të zotërohet mirë sintaksa; të fitojnë njohuri teorike, t'i njohin konceptet gramatikore dhe të përvetësojnë normën gramatikore si sistem, dhe të kenë kompetencë të thellë për gramatikën; të kuptojnë prirjet e përgjithshme të zhvillimit të gjuhës dhe teoritë e reja që lidhen me të.
7	Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, punime seminarike, teste provuese, prezantime, provim përfundimtar.

8	Vlerësimi dhe notimi	Vlerësimi me pikë: 01–49= 5, 50–60 = 6, 61–70 = 7, 71–80 = 8, 81–90 = 9, 91–100=10
9	Literatura:	1. Memushaj, Rami, Morfonologji e eptimit të shqipes standarde, Infbotues, Tiranë, 2012. 2. Beci, Bahri, Gramatika e gjuhës shqipe, EDFA, Tiranë, 2010. 3. ASHSH, Gjuha shqipe I, IGJLSH, Tiranë, 2002.

Viti I – Semestri II

Lëndët obligative:

S2 Mësimdhënësi: Prof.ass.dr. Ilir Krusha		
Nr.	Lënda:	2.1 Gjuhë Gjermane II, Praktikë gjuhe (A2/2)
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri II
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatjadhe proporcioni:	15 javë, 2+2
5	ECTS kreditë:	4
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	Lënda ka për qëllim, si vazhdimi i semestrit paraprak, t'i ofrojë studentit zgjerimin e njohurive elementare gramatikore. Qëllim yni është praktikimi i gjuhës gjermane në të folur dhe në të shkruar nga studentët. Kjo lëndë synon vazhdimin e zhvillimit të shkathtësive komunikative dhe sociale të nevojshme për komunikim në këtë gjuhë: të shkruarit, të lexuarit, të folurit dhe të dëgjuarit. Ushtrohen strategji të ndryshme të të lexuarit dhe dëgjuarit (global, selektiv e të detajuar). Po ashtu ushtrohen shkathtësitë produktive (tiparet e llojeve të ndryshme të teksteve, të të folurit) dhe ato receptive. Të katër shkathtësitë do të ushtrohen përmes trajtimit të temave të ndryshme. Me anë të temave që do të përpunohen gjatë këtij semestri bëhet pasurimi i leksikut të studentëve me fjalë të reja të nivelit gjuhësor të lartpërmedur. Për zhvillimin e mësimi do të përdoren krahas teksteve nga libri bazë edhe tekste autentike që ndërlihen me përditshmërinë, gramatikat e gjuhës gjermane për të huaj, CD-të për ushtrimin e shkathtësisë së të dëgjuarit dhe format digjitale, të cilat i ofron botuesi i literaturës, siç janë: platformë e internetit për ushtrime online dhe aplikacione për celularët mobilë etj. Gjatë ushtrimeve studentët do të prezantojnë edhe punime seminarike

		<p>me tema të ndryshme, të cilat janë në përputhje me programin e lëndës.</p> <p>Objektivat e lëndës:</p> <p>t'i aftësojë studentët të kombinojnë gjuhën me shkathhtësitë reale jetësore;</p> <p>të ngrisë aftësinë e studentëve për të komunikuar për tema të caktuara me folësit e gjermanishtes;</p> <p>t'i mundësohet studentit të bëhet përdorues eficient dhe fleksibil i gjuhës gjermane si për qëllime personale po ashtu edhe për ato profesionale;</p> <p>të inkurajohet mësimnxënja e pavarur.</p>
	Rezultatet e pritura:	<p>zhvillimi i shkathhtësive receptive dhe produktive të studentit në nivelin A2 të Kornizës së Përbashkët Europiane për gjuhë;</p> <p>të dëshmojë që zotëron njohuri bazë të gramatikës gjermane;</p> <p>të kuptojë informacionet në biseda të jetës së përditshme, por edhe njoftime në radio apo mesazhe në telefon;</p> <p>të nxjerrë informacione të caktuara nga artikuj gazetash, njoftime që kanë të bëjnë me jetën e përditshme dhe nga tabela udhëzuese;</p> <p>të trajtojë tema të ndryshme nga mediat elektronike dhe të shkruara;</p> <p>të shkruajë mesazhe dhe letra zyrtare, të cilat lidhen drejtpërdrejt me mjedisin që i rrethon;</p> <p>të formulojë pyetje rreth temave të caktuara dhe të reagojë ndaj tyre;</p> <p>në biseda të përditshme të bjerë dakord ose të negociojë për diçka.</p>
7	Metodat e mësimdhënies:	<p>Mësimi realizohet nëpërmjet përdorimit të metodave të kombinuara dhe qasje kognitive, komunikative dhe ndërkulturore për ta arritur përmirësimin e shkathhtësive receptive dhe produktive gjuhësore. Përmes metodës bashkëbiseduese punohet në mënyrë individuale, në çifte dhe në grupe. Studentët duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në mësim dhe të punojnë vazhdimisht gjatë semestrit (detyra të shtëpisë dhe projekte të ndryshme).</p>
8	Vlerësimi dhe notimi	<p>Vlerësimi me pikë: 01-49= 5, 50-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10</p> <p>Provimi:</p> <p>të dëgjuarit– 20%</p> <p>të lexuarit – 20%</p> <p>të shkruarit –20%</p> <p>të folurit – 20%</p> <p>Pjesëmarrja & aktiviteti: 20 %</p>
9	Literatura:	<p>Literatura bazë:</p> <p>Specht/Habersack/Pude: Menschen A2/2. Kursbuch mit DVD-</p>

	<p>ROM. Niveau: A2/1. Hueber Verlag 2013.</p> <p>Sarita Batra/Karin Ransberger: Menschen A2: Deutsch als Fremdsprache/Intensivtrainer mit Audio-CD . 2016.</p> <p>Literatura shitesë</p> <p>Christiane Lemcke, Lutz Rohrmann/Grammatik Intensivtrainer NEU A2/ Deutsch als Fremdsprache (DaF) Niveau: A2/Klett Verlag 2017.</p> <p>Christiane Lemcke, Lutz Rohrmann/Wortschatz Intensivtrainer NEU A2/ Deutsch als Fremdsprache (DaF) Niveau: A2/Klett Verlag 2017.</p> <p>Christiane Lemcke, Lutz Rohrmann/Schreiben Intensivtrainer NEU A2/ Deutsch als Fremdsprache (DaF) Niveau: A2/Klett Verlag 2017.</p> <p>Duden: Die Grammatik (Der Duden Band 4). 7., völlig neu erarbeitete und erweiterte Auflage. Mannheim. Dudenverlag 2005.</p> <p>Karin Hall / Barbara Scheiner: Übungsbuchgrammatik. Deutsch als Fremdsprache. Max Huber Verlag 2001.</p> <p>Langenscheidt Handwörterbuch Deutsch-Albanisch Albanisch-Deutsch, Langenscheidt 1999.</p> <p>Langenscheidt Wörterbuch Deutsch als Fremdsprache Bild für Bild - Bildwörterbuch: 7.500 Begriffe, Redewendungen und Sätze in tausenden Bildern, Deutsch (Langenscheidt Wörterbuch Bild für Bild) Taschenbuch. 2016.</p> <p>Wiebke Strank: Da fehlen mir die Worte. Systematische Wortschatzerwerb für fortgeschrittene Lerner in Deutsch als Fremdsprache. Schubert Verlag. Leipzig 2010.</p>
--	---

S2 Mësimdhënësi: Prof.asoc.dr. Izer Maksuti		
Nr.	Lënda:	2.2 Fonetikë dhe fonologji e gjuhës gjermane
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri II
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatjadhe proporcioni:	15 javë, 2+2
5	ECTS kreditë:	6

6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	Lënda synon të merret fillimisht me definicionet bazë të fonetikës dhe fonologjisë, fokusimi në karakteristikat fonetike të shqiptimit të gjermanishtës dhe në bazat e karakterizimit të tipologjisë së gjermanishtes t'i sqaroj vështirësitë në nivelin standard të tingujve. Lënda referuese: Praktikë gjuhe I, VIII; Gjuhë e sotme gjermane, kjo lëndë do t'i adresojë vështirësitë e veçanta të shprehjeve gojore të gjermanishtes. Objektivat dhe rezultatet e pritshme të lëndës: të kuptuarit e koncepteve themelore të fonetikës dhe fonologjisë është një nga synimet kryesore të lëndës; të kuptuarit e proceseve të nyjetimit të tingujve dhe parimeve fonetike dhe fonologjike të gjermanishtes; mësimi i alfabetit ndërkombëtar fonetik dhe aftësimi i studentëve për shfrytëzimin e tij; njohja me parimet e transkriptimit fonetik (IPA).
	Rezultatet e pritura:	Pas përfundimit me sukses të këtij kursi, studenti do të jetë në gjendje që: t'i kuptojë proceset e rregullta fonetike dhe fonologjike dhe proceset e nyjetimit të tingujve të gjermanishtes; t'i përshkruajë tingujt e gjermanishtes sipas kritereve fonetike dhe fonologjike; t'i zbatojë konceptet e përvetësuara teorike të fonetikës dhe fonologjisë.
7	Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, 2 pjesë provimesh, prezantime, provimi përfundimtar.
8	Vlerësimi dhe notimi	Vlerësimi me pikë: 01-49= 5, 50-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10 / Pjesëmarrja & aktiviteti: 20 %; Pjesa e parë e provimit: 30 % ; Pjesa e dytë e provimit: 30%; Provimi me gojë: 20 %
9	Literatura:	Staffeldt, Seven (2010): Einführung in die Phonetik, Phonologie und Graphematik des Deutschen: Ein Leitfadens für den akademischen Unterricht. Verlag: Stauffenburg. Noack, Christina (2010): Phonologie. Heidelberg: Winter. Wiese, Richard (2011): Phonetik und Phonologie. Paderborn: Fink DUDEN 2005. Aussprachewörterbuch. Bd. 6. Mannheim: Duden Verlag

S2 Mësimdhënësi: Prof.ass.dr. Naim Kryeziu

Nr.	Lënda:	2.3 Letërsi gjermane I
-----	--------	------------------------

1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri II
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatjadhe proporcioni:	15 javë, 2+2
5	ECTS kreditë:	6
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	<p>Qëllimi kryesor i lëndës është që në këtë semestër studentët të marrin njohuri të përgjithshme mbi letërsinë e mesjetës gjermane, ku do të ofrohen njohuri të përgjithshme mbi letërsinë në gjuhën e vjetër gjermane, pastaj duke u futur në mesjetën e hershme gjermane. Fokus i veçantë i shtohet zhvillimit të letërsisë në mesjetën e lashtë dhe mesjetën e vonë gjermane. Studentët do të kenë mundësinë që nga afër të vërejnë zhvillimin e gjuhës gjermane, por edhe ndryshimet e stilit në letërsi, dhe qëllimet e të shkruarit në kohërat e hershme. Në përgjithësi do të jetë një vështrim mbi letërsinë e mesjetës në përgjithësi dhe një vështrim i përgjithshëm i veprave, gjinive, producentëve dhe recipientëve të letërsisë në mesjetë, si dhe një vështrim mbi funksionin e letërsisë në mesjetë dhe në kohën e hershme të re.</p> <p>Brenda kësaj periudhe studentët do të njihen me krijimtarinë letrare të autorëve më të rëndësishëm të këtyre periudhave. Ata do të mësojnë për gjinitë kryesore letrare, do të njihen me prapavijën historike dhe ndikimin e saj në tekste letrare. Brenda këtij semestri janë të parapara gjithashtu analiza dhe interpretime të veprave më të rëndësishme nga përfaqësuesit e këtyre epokave.</p>
	Rezultatet e pritura:	Të ketë një pasqyrë të përgjithshme mbi letërsinë gjermane të mesjetës në përgjithësi dhe, po ashtu t'i njëhë në përgjithësi veprat, zhanret, producentët dhe recipientët e letërsisë së mesjetës gjermane.
7	Metodat e mësimdhënies:	Në procesin e mësimdhënies zbatohet metodologjia bashkëkohore. Format e ndryshme të ligjërimit të modifikuar, punë e pavarur e studentëve sipas formave bashkëkohore të bashkëpunimit (reflektim individual me gojë e me shkrim, punë në dyshe, punë në grupe të vogla, lexim i vëmendshëm dhe detyra me shkrim).
8	Vlerësimi dhe notimi	Vlerësimi me pikë: 01-49= 5, 50-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10 / Pjesëmarrja & aktiviteti: 20 %; Pjesa e parë e provimit: 30 % ; Pjesa e dytë e provimit: 30%; Provimi me gojë: 20 %
9	Literatura:	A., Herbert und Frenzel, Elisabeth: Daten der deutschen Dichtung. Chronologischer Abriß der deutschen Literaturgeschichte. Band 1. Von den Anfängen bis zum Jungen Deutschland. München:

		<p>Deutscher Taschenbuch Verlag, 1997.</p> <p>Balzer, Bernd und Mertens, Volker: Deutsche Literatur in Schlaglichtern. Mannheim, Wien, Zürich: Meyers Lexikonverlag, 1990.</p> <p>Boockmann, Hartmut: Einführung in die Geschichte des Mittelalters. München, 2001.</p> <p>Brunner, Horst: Geschichte der deutschen Literatur des Mittelalters im Überblick. Stuttgart: Reclam, 2000.</p>
--	--	---

S2 Mësimdhënësi: Prof.ass.dr. Ilir Krusha		
Nr.	Lënda:	2.4. Civilizimi dhe kultura gjermane II
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri II
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatjadhe proporcioni:	15 javë, 2+1
5	ECTS kreditë:	4
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	Do të trajtohen ngjarjet dhe personalitetet më të rëndësishme historike e kulturore, proceset sociale dhe ekonomike, të arritura kryesore në filozofi, në artin figurativ, të arkitekturës, letërsisë, si dhe fenomene tjera kulturore në të kaluarën (institucionet më të rëndësishme, jeta e përditshme, botëkuptimet etj.). Do të trajtohet zhvillimi kulturor e ai shoqëror, si dhe politik i territoreve gjermanofolëse, nga Epoka e Barokut e deri në ditët e tona.
	Rezultatet e pritura:	Në këtë semester studetët marrin njohuri themelore për historinë e kulturës gjermane prej kohës së reformacionit deri në ditët tona. Njëkohësisht, ata e krijojnë një vetëdije kritike të zhvillimit dhe të identitetit kulturor, bëjnë ndërlidhjen e aspekteve të ndryshme të kulturës dhe janë në gjendje t'i dallojnë dhe t'i interpretojnë ato në mënyrë të pavarur.
7	Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, 2 pjesë provimesh, prezantime, provimi përfundimtar
8	Vlerësimi dhe notimi	Vlerësimi me pikë: 01-49= 5, 50-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10 / Pjesëmarrja & aktiviteti: 20 %; Pjesa e parë e provimit: 30 % ; Pjesa e dytë e provimit: 30%; Provimi me gojë: 20 %
9		Literatura bazë:

	Literatura:	<p>Beyme, Klaus: Kulturpolitik in Deutschland: Von der Staatsförderung zur Kreativwirtschaft, Springer Fachmedien, Wiesbaden, 2012.</p> <p>Demant, Alexander: Über die Deutschen. Eine kleine Kulturgeschichte, Propyläen-Berlin, 2009.</p> <p>Fridell, Egon: Kulturgeschichte der Neuzeit, Bd 1 dhe 2, dtv, 1976.</p> <p>Gössmann, Wilhelm: Deutsche Kulturgeschichte im Grundriss, Gruppello Verlag- Düsseldorf, 2006.</p> <p>Hamann, Richard: Geschichte der Kunst, Th.Knaur-Verlag, München, 1932, S.377-476;681-896.</p> <p>Jordan, Gerda, Deutsche Kultur in Epochen, Peter Lang, New York, 1993.</p> <p>Kleine deutsche Geschichte, Reclam, Stuttgart, 2006.</p> <p>Naumann, Günter, Deutsche Geschichte. Das Alte Reich 925-1806, Marix Verlag Wiesbaden.</p> <p>Van Dülmen, Richard: Kultur und Alltag in der Frühen Neuzeit. Das Haus und seine Menschen, C. H. Beck, München, 2005.</p> <p>Online resurset:</p> <p>https://www.tatsachen-ueber-deutschland.de/de/system/files/download/tatsachen_2015_deu.pdf</p> <p>https://www.tatsachen-ueber-deutschland.de/partner/epaper/epaper-Jugendbuch_TuD_2015_DEU/</p> <p>Literatura shitesë:</p> <p>Clark K. Zivilisation, Rowohlt, Hamburg, 1970</p> <p>Moebius S./Quadflieg D. (Hrsg.), Kultur.Theorien der Gegenwart, VS Verlag, Wiesbaden, 2006</p>
--	-------------	--

S2 Mësimdhënësi: Prof.dr. Muhamet Hamiti		
Nr.	Lënda:	2.5 Gjuhë angleze I
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri II
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatja dhe	15 javë, 2+2

	proporcioni:	
5	ECTS kreditë:	4
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	Lënda synon prezantimin dhe ushtrimin e gjuhës angleze në nivelin përkatës të aftësisë për të komunikuar në mënyrë efektive gjatë situatave të përditshme në shoqëri dhe punë. Theks i veçantë i përkushtohet zhvillimit të katër shkathtësive të integruara të gjuhës përmes qasjes komunikative të mësimin të gjuhës. Studentët zhvillojnë aftësinë e përdorimit të drejtë të strukturave gjuhësore, rrjedhshmërinë në të folur dhe zgjedhjen e gjuhës së përshtatshme, duke ushtruar gjuhën në situata me përmbajtje nga jeta e vërtetë.
	Rezultatet e pritura:	Në fund të semestrit studentët do të jenë në gjendje të identifikojnë qëllimin kryesor dhe hollësitat lidhur me komunikimin gojor; të shprehin idetë dhe mendimet në mënyrë të qartë dhe efektive, duke i përdorur shprehjet e duhura gramatikore dhe fjalorin e përshtatshëm; të zhvillojnë mendimin kritik dhe shkathtësitë analitike.
7	Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, punime seminarike, teste provuese, prezantime, provim përfundimtar
8	Vlerësimi dhe notimi	Vlerësimi me pikë: 100-95 - 10 94 – 88 – 9 87 – 79 – 8 78 – 67 – 7 66 – 51 – 6 Prania në klasë 10 Pjesëmarrja në klasë 12 Detyrat e shtëpisë 22 Punime semestrale 18 Provimi me shkrim 38
9	Literatura:	Strange, D. & Hall, D. (2000). Pacesetter: elementary level. Oxford: Oxford University Press.

S2 Mësimdhënësi: Prof.ass.dr. Xhafer Beqiraj

Nr.	Lënda:	2.6 Gjuhë shqipe II
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri II
3	Obligative/ zgjedhore:	Obligative

4	Kohëzgjatja dhe proporcioni:	15 javë, 2 + 2
5	ECTS kreditë:	5
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës:	<p>Lënda (kursi) ka për qëllim që studentët: të kuptojnë drejt objektin studimor të disiplinës së sintaksës (së fjalisë dhe periudhës), e cila është njëra nga disiplinat më me rëndësi të gjuhës. Njohja në nivel të duhur të Gjuhës shqipe II (Sintaksës) do t'u ndihmojë studentëve të Programit të Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane të mësojnë dhe përvetësojnë më lehtë dhe më mirë sintaksën e gjermanishtes;</p> <p>të njihen thellësisht me strukturën sintaksore të shqipes së sotme dhe të trajtojnë teorikisht nocionet gramatikore;</p> <p>t'i njohin mirë llojet e togfjalëshave dhe llojet e gjymtyrëve;</p> <p>t'i mësojnë gjymtyrët e fjalisë, formimin dhe funksionin e tyre në fjali, si dhe lidhjen dhe përshtatjen midis tyre për të derivuar fjali të drejta gramatikore;</p> <p>të aftësohen për njohjen sa më të mirë të lidhjeve të fjalëve në fjali dhe të fjalive në periudhë;</p> <p>t'i njohin fjalitë e përbëra (periudhat) dhe llojet e tyre;</p> <p>t'i zotërojnë konceptet dhe termat sintaksorë dhe të jenë të aftë t'i zbatojnë praktikisht në shkrimet e tyre;</p> <p>t'i zhvillojnë aftësitë e komunikimit dhe transmetimit të dijes së tyre;</p> <p>të jenë në gjendje të zbatojnë njohuritë e fituara nga fusha e sintaksës;</p> <p>të aftësohen për punë kërkimore-hulumtues individuale e grupe;</p> <p>-t'i zhvillojnë aftësitë për të hulumtuar, krahasuar, analizuar e për të sintetizuar etj.</p>
	Rezultatet e pritura:	<p>Pikësypnim kryesor i lëndës është që studentët: të kuptojnë se njohja e sintaksës së shqipes është me rëndësi të veçantë jo vetëm për të zotëruar në nivel të duhur gjuhën amtare, por përmes saj studentët do ta kenë më të lehtë mësimin e gramatikës (sintaksës) së gjermanishtes;</p> <p>t'i përvetësojnë njohuritë për të shkruar drejt dhe pa gabime në aspektin drejtshkrimor (morfologjik e sintaksor);</p> <p>t'i njohin mirë strukturat e formimit të fjalisë, duke filluar nga sintagmat, gjymtyrët e fjalisë, fjalia e deri te periudha dhe periudha e tekstit;</p> <p>të jenë të aftë pas përfundimit të këtij kursi që të shkruajnë shkrime të nivelit akademik me struktura të ndërlikuara sintaksore;</p> <p>- të fitojnë njohuri teorike, t'i njohin konceptet gramatikore dhe të përvetësojnë normën gramatikore si sistem, dhe të kenë kompetencë të thellë për gramatikën;</p>

		- të kuptojnë prirjet e përgjithshme të zhvillimit të gjuhës dhe teoritë e reja që lidhen me të.
7	Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, punime seminarike, teste provuese, prezantime, provim përfundimtar
8	Vlerësimi dhe notimi	Vlerësimi me pikë: 01–49= 5, 50–60 = 6, 61–70 = 7, 71–80 = 8, 81–90 = 9, 91–100=10
9	Literatura:	1. Çeliku, Mehmet, Sintaksa e gjuhës shqipe, Ilar, Tiranë, 2012. 2. Topalli, Teftë, Sintaksa e fjalisë, ISA, Shkodër, 2011. 3. ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe II , Tiranë, 2002.

S2 Mësimdhënësi: Prof.ass.dr. Ilir Krusha		
Nr.	Lënda:	2.7 Gjermanishtja e ekonomisë
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti I, semestri II
3	Obligative/zgjedhore:	Zgjedhore
4	Kohëzgjatja dhe proporcioni:	15 javë, 2+1
5	ECTS kreditë:	4
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	<p>Lënda “Gjermanishtja e ekonomisë” është lëndë praktike që u mundëson studentëve të njihen me terminologjinë gjermane nga fusha e ekonomisë. Krahas fjalorit mësohen edhe strukturat gramatikore tipike për komunikimin në ndërmarrje. Kjo lëndë synon të aftësojë studentët në komunikim profesional në fushën e biznesit. Mëtuje, gjatë semestrit studentët do të mësojnë, se si t’i prezantojnë produktet dhe shërbimet e biznesit në gjermanishte, aty duhet të bëhen biseda dhe kontrata të ndryshme.</p> <p>Objektivat dhe rezultatet e pritshme të lëndës:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të zhvillohen shkathtësitë receptive dhe produktive të studentit në fushën e ekonomisë; - të zgjerohet fjalori i studentit me terminologjinë ekonomike; - të ushtrohet hartimi i letrave të ndryshme zyrtare, etj.;

	Rezultatet e pritura:	Pas përfundimit të suksesshëm të kësaj lënde, studentët do të jenë në gjendje: të komunikojnë me folësit e gjermanishtes në situata konkrete në fushën e ekonomisë; të hartojnë lloje të ndryshme të letrave zyrtare; të përdorin shkathtësitë e tyre ndërpersonale në kontekste të ndryshme.
7	Metodat e mësimdhënies:	Ligjërata, ushtrime, 2 pjesë provimesh, prezantime, provimi përfundimtar.
8	Vlerësimi dhe notimi	Vlerësimi me pikë: 01-49= 5, 50-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10 / Pjesëmarrja & aktiviteti: 20 %; Pjesa e parë e provimit: 30 % ; Pjesa e dytë e provimit: 30%; Provimi me gojë: 20 %
9	Literatura:	Buhlmann, Rosemarie/ Fearn, Anneliese/ Leimbacher, Eric (2008): Wirtschaftsdeutsch von A – Z. Kommunikation und Fachwortschatz in der Wirtschaft. Lehr- und Arbeitsbuch. Berlin/ München u.a.: Langenscheidt. Fearn, Anneliese/ Lévy-Hillerich, Dorothea (Hrsg.) (2009): Kommunikation im Beruf - Für alle Sprachen: B1/B2 - Kommunikation in der Wirtschaft: Kursbuch mit Glossar auf CD-ROM. Cornelsen Verlag. Eismann, Volker (2008): Wirtschaftskommunikation Deutsch. München: Langenscheidt.

Viti II – Semestri III

Lëndët obligative:

S3 Mësimdhënësi: Mag. Martina Drescher, OEAD Lektorin (A)		
Nr.	Lënda:	3.1 Gjuhë Gjermane III, Praktikë gjuhe (B1/1)
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti II, semestri III
3	Obligative/zgjedhore:	Zgjedhore
4	Kohëzgjatjadhe proporcioni:	15 javë, 2+4
5	ECTS kreditë:	5
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	Zhvillimi i shkathtësive komunikative dhe sociale për komunikim më të zgjeruar në të shkruar, të lexuar, të folur dhe të dëgjuar janë qëllim i këtij kursi. Të katër shkathtësitë do të ushtrohen përmes trajtimit të temave të ndryshme, me anë të së cilave gjatë këtij semestri bëhet pasurimi i leksikut të studentëve me fjalë të reja të

		<p>nivelit B1/1. Për zhvillimin e mësimit do të përdoren krahas teksteve nga libri bazë edhe tekste autentike që ndërlidhen me përditshmërinë, gramatikat e gjuhës gjermane për të huaj, CD-të për ushtrimin e shkathhtësisë së të dëgjuarit edhe format digjitale, të cilat i ofron botuesi i literaturës, siç janë: platformë e internetit për ushtrime online dhe aplikacione për celularët mobilë etj. Gjatë ushtrimeve studentët do të prezantojnë edhe punime seminarike me tema të ndryshme, të cilat janë në përputhje me programin e lëndës.</p> <p>Objektivat e lëndës: që studentit t'i ofrojë njohuri të përgjithshme gramatikore e gjuhësore; t'i aftësojë studentët të kombinojnë lirshëm dhe pa gabime gjuhën. të ngrisë aftësinë e studentëve për të bashkëbiseduar dhe prezentuar në tema më të zgjeruara; të aplikohet mësimnxënia e pavarur;</p>
	Rezultatet e pritura:	<p>të dëshmojë që zotëron njohuri të qëndrueshme të gjuhës gjermane në jetën e përditshme dhe që ia del nga ana gjuhësore në të gjitha situatat e rëndësishme të jetës së përditshme; të kuptojë informacionet nga artikuj të ndryshëm, pretendime për tema të caktuara dhe bashkëbisedime; të nxjerrë informacione të caktuara nga artikuj gazetash, njoftime që kanë të bëjnë me situata të ndryshme; të trajtojë tema të ndryshme nga mediat elektronike dhe të shkruara; të shkruajë mesazhe dhe letra zyrtare, të komentojë dhe të japë mendime rreth temave të caktuar; të jetë në gjendje të mbajë prezantime për tema të ndryshme; të jetë në gjendje të ofrojë dhe kundërshtojë argumente dhe mendime; të ketë shqiptim të përafërt të gjuhës gjermane si gjuhë amtare.</p>
7	Metodat e mësimit:	<p>Në procesin e mësimit zbatohet metodologjia bashkëkohore. Format e ndryshme të ligjërimit të modifikuar, punë e pavarur e studentëve sipas formave bashkëkohore të bashkëpunimit (reflektim individual me gojë e me shkrim, punë në dyshe, punë në grupe të vogla, lexim i vëmendshëm dhe detyra me shkrim).</p>
8	Vlerësimi dhe notimi	<p>Vlerësimi me pikë: 01-49= 5, 50-60 = 6, 61-70 = 7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10</p> <p>Provimi: të dëgjuarit – 20% të lexuarit – 20% të shkruarit –20%</p>

		të folurit – 20% pjesëmarrja & aktiviteti: 20 %
9	Literatura:	<p>Literatura:</p> <p>Orth-Chambah/Perlmann-Balme/Schwalb: Sicher! Deutsch als Fremdsprache. Niveau B1. Hueber Verlag 2012.</p> <p>Marion Lütke: Aspekte neu B1 plus/Mittelstufe Deutsch/Intensivtrainer- Klett 2017.</p> <p>Literatura shitesë</p> <p>Langenscheidt Großwörterbuch Deutsch als Fremdsprache: Deutsch-Deutsch (Einsprachige Wörterbücher) 2015</p> <p>Buscha/Szita: Deutsch als Fremdsprache. Übungsgrammatik. Sprachniveau B1. Schubert Verlag. Leipzig 2011.</p> <p>Dreyer/Schmitt: Lehr- und Übungsbuch der deutschen Grammatik. Max Hueber Verlag. Muenchen 2010.</p> <p>Duden: Die Grammatik (Der Duden Band 4). 7., völlig neu erarbeitete und erweiterte Auflage. Mannheim. Dudenverlag 2005.</p> <p>Helbig/Buscha: Deutsche Grammatik: Ein Handbuch für den Ausländerunterricht, Langenscheidt 2008.</p> <p>Karin/Scheiner: Übungsbuchgrammatik. Deutsch als Fremdsprache. Max Hueber Verlag 2001.</p> <p>Wiebke Strank: Da fehlen mir die Worte. Systematische Wortschatzerwerb für fortgeschrittene Lerner in Deutsch als Fremdsprache. Schubert Verlag. Leipzig 2010.</p>

S3 Mësimdhënësi: Prof.ass.dr. Kimete Canaj		
Nr.	Lënda:	3.2 Morfologji e gjuhës gjermane
1	Programi i studimit:	Gjuhë dhe Letërsi Gjermane
2	Viti akademik:	Viti II, semestri III
3	Obligative/zgjedhore:	Obligative
4	Kohëzgjatjadhe proporcioni:	15 javë, 2+2
5	ECTS kreditë:	5
6	Përshkrimi dhe qëllimi i lëndës	Lënda synon të merret fillimisht me definicionet bazë të morfologjisë, fokusimi në karakteristikat morfologjike të gjuhës gjermane dhe në bazat e karakterizimit të tipologjisë së gjermanishtes t'i sqarojë vështirësitë morfologjike të gjuhës gjermane. Kjo lëndë do t'i adresojë vështirësitë e veçanta të

		shprehjeve gojore të gjermanishtes: të kuptuarit e koncepteve themelore morfologjike është një nga synimet kryesore të lëndës; të kuptuarit e proceseve morfologjike dhe parimeve morfologjike të gjermanishtes; mësimi i pjesëve të ligjëratës dhe aftësimi i studentëve për aplikimin e tyre në mënyrë të drejtë.
	Rezultatet e pritura:	Njohja me parimet dhe proceset e rregullta morfologjike të gjuhës gjermane: të bëjë analizën morfologjike të fjalëve dhe të bëjë dallimin dhe klasifikimin e morfemave; t'i përshkruajë dhe t'i dallojë pjesët e ligjëratës në gjuhën gjermane sipas kriterëve morfologjike; t'i zbatojë konceptet e përvetësuara teorike të morfologjisë; të njohë e të përdorë në mënyrë korrekte pjesët e ligjëratës të gjermanishtes.
7	Metodat e mësimdhënies:	Ligjëratë, ushtrime, 2 pjesë provimesh, prezantime, provimi përfundimtar
